



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

OSNOVNI SUD MITROVICA – BASIC COURT OF MITROVICA

C.nr.355/2014

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE, Gjyqtari Ragip Kadriu ne qeshtjen juridike te paditësit: nga , te cilin e perfaqeson sipas autorizimit av. nga kunder te paditurve: dhe qe te dy nga , tani me adrese te panjohur te cilet i perfaqeson perfaqesuesi i perkoheshem av. nga , sipas aktvendimit te kesaj gjykate, baza e kontestit: Vertetim pronesie, vlera e lendes se kontestit: 5.000,00 Euro, pas mbajtjes se shqyrtimit kryesor te dt.06.06.2017, jep kete:

A K T G J Y K I M

APROVOHET kerkespadia e paditësit: nga i dhe **VERTETOHET** se paditesi eshte pronar i paluajtshmerise, parc.kat. ne vendin e quajtur “ ” me kulture oborr me siperfaqe prej 0.00.43 ha, shtepi me siperfaqe prej 0.00.32 ha, si dhe parc.kat. me kulture oborr ne siperfaqe prej 0.00.50 ha, shtepi me siperfaqe prej 0.00.32 ha ne vendin e quajtur “ ” e cila paluajtshmeri evidentohet ne emer te , l/l sipas çertifikates se pronesise nr.

Detyrohen te paditurit qe t’i njohin kete te drejte paditësit dhe t’i lejoj qe paditesi kete paluajtshmeri ta regjistroi ne emer te tij pranë Drejtorise per Kataster dhe Gjeodezi ne ne afatin prej 15 diteve nga dita e pranimi te këtij aktgjykimi.

Secila pale i barte shpenzimet e veta te procedures kontestimore.

A r s y e t i m

Paditesi ne padine e parashtruar si dhe nepermjet te autorizuarit te tij ka theksuar se i padituri i pare me 04.02.1955 i ka shitur paluajtshmerine e tij te paditurit te dyte, e cila tani kjo paluajtshmeri evidentohet si parc.kat. dhe ZK

Paluajtshmerine e sipercekur i padituri e ka blere nga i padituri i dyte me dt.11.10.1956 dhe qe nga atehere ka hyre ne posedim faktik te kesaj paluajtshmerie.

I autorizuari i paditesit i propozoi gjykates qe te paditurve te cilet jane ne vendbanim te panjohur per paditesin te njejtut ti caktoi perfaqesuesin e perkoheshem.

Ne fjalen perfundimtare i autorizuari i paditesit i propozon gjykates qe padine dhe kerkesepadine ta aprovoj si te bazuar nga se paditesi kete palujtshmeri e ka fituar ne baze te mbajtjes me mirebesim me teper se 20 vite.

Shpenzimet e procedures kontestimore nuk i kerkoi.

Ne baze te propozimit te paditesit e konform nenit 84 al.2 pika 4 si dhe nenit 85 te LPK-es, gjykata me aktvendimin e saj C.nr.355/14 te dt.30.09.2016, te paditurve iu caktoi perfaqesuesin e perkoheshem, av. nga

Perfaqesuesi i perkoheshem i te paditurve ne seancen e shqyrtimit kryesor ne fjalen perfundimtare i propozoj gjykates qe gjykata qe te vendos ne baze te rezultatit te provave te zhvilluara dhe ligjit.

Shpenzimet e procedures kontestimore i kerkoi.

Gjykata ne seancen e shqyrtimit kryesore zhvilloi provat e propozuara dhe te nevojshme dhe pas administrimit dhe vlersimit te te njejtave ne kuptim te nen. 8 te LPK, erdhi ne perfundim se duhet vendosur si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

Gjykata ne proceduren e provave lexoi: Qertifikaten e pronesise dhe te dt.26.04.2017, Ekspertizen e ekspertit gjeodet te dt.27.04.2017, Aktvendimin e Komunes te dt.30.12.1975, Kopjen e Planit te dt.06.06.2014, Deftesen e dt.14.01.1976, Deftesen e dt.11.10.1956, beri veshtrimin ne skicen e terenit te dt.26.04.2017 dhe konstatoi te gjenjete faktike.

Nga qertifikatat e pronesise te sipercekur konstatohet se palujtshmeria tani lendore evidentohet ne emer te paditurit te pare.

Nga skica e terenit e sipercekur shifet shtrirja, siperfaqja dhe perkufizimi i palujtshmerise tani lendore.

Nga konstatimi dhe mendimi i ekspertizes gjeodet te sipercekur konstatohet se: palujtshmeria tani lendore shtrihet dhe evidentohet ne parc.kat te cekura si ne dispozitiv.

Nga deftesa e dt.11.10.1956 eshte konstatuar se i padituri i dyte nga ka pranuar shume prej 490.000 dinar ne emer te shitblerjes se shtepise.

Nga Aktvendimet e Komunes se te dt.30.12.1975 konstatohet se ka qene i ngarkuar me tatim ne prone tani lendore.

Ne nje gjendje te ketille faktike, gjykata kerkesepadine e paditesit e aprovoi si te bazuar konform nenit 28 al.4 te Ligjit mbi Marrdhenjet Themelore Pronesoro – Juridike (

i vjeter) i aplikueshem ne rastin konkret konform nenit 282.2 te Ligjit per Pronesine dhe te Drejatat tjera Sendore (Ligji nr.03-L-54) .

Ne baze te nenit 28. al. 4 te te njejtij ligj eshte percaktuar se: personi i cili me mirebesim e ka 20 vjet ne posedim te panderprere nje palujteshmeri ose nje pjese te saj e fiton pronesin ne te .

Ne rastin konkret nga momenti i shitblerjes, qysh ne vitin 1956 paditesi e ka ne shfrytezim dhe disponim te lire kete patundeshmeri dhe ate: me mirebesim dhe pa pengesa nga askush. Prandaj ne anen e paditesit ekzistojne te gjitha bazat ligjore per fitimin e pronesise ne baze te mbajtjes e keto jane: mbajtja me mirebesim, koha e nevojshme si dhe shfrytezimi i papengueshem i kesaj patundeshmerie.

Mbajtja me mirebesim ekziston se: kete palujteshmeri paditesi e ka blere nga pronari faktik i saj. Koha e nevojshme mbi 20 vite, ekziston sepse paditesi e ka blere kete palujteshmeri nga i padituri i dYTE qysh ne vitin 1956.

Gjithashtu nga momenti i shitblerjes paditesi ka hyre ne posedim dhe shfrytezim te lire dhe te papengueshem te kesaj palujteshmerie. Prandaj gjykata konstaton se ne rastin konkret kemi te bejme me fitimin e pronesise nga ana e paditesit ne menyre – derivative me mbajtje, konform nenit 28. Al.4. te LMTHPJ. Palujteshmerin lendore paditesi e ka fituar me parashkrim fitues nga se posedimi i saj eshte me kohezgjatje mbi 20 vite te kerkuara edhe me nenin 40 parag. 1 te Ligjit per Pronesine dhe te drejatat tjera sendore (Ligji nr.03/L-54).

Vendimi mbi shpenzimet e procedures kontestimore bazohet ne dispoziten e nenit 450 te LPK-es.

Nga si u tha me larte u vendos si ne dispozitive te ketij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE

C.nr.355/2014, me dt.06.06.2017

**Gjyqtari,
Ragip Kadriu**

KESHILLE JURIDIKE: Kunder ketij aktgjykimi mund te ushtrohet ankese ne afatin prej 15 diteve nga dita e pranimit, Gjykates se Apelit te Kosoves, e permes kesaj gjykate.